



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 16 janar 2020
Nr. ref.:RK 1499/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI140/18

Parashtrues

Naim Osmani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 36/2018, të 30 prillit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naim Osmani, të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Pml. nr. 36/2018, të 30 prillit 2018, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës. Aktgjykimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar më 17 korrik 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 11 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ), dhe nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejme: PNDKP), si dhe me nenet 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu, (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
7. Më 14 nëntor 2018, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës, kopjen e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P. nr. 649/2016, të 23 gushtit 2017, ankesën e tij drejtuar Gjykatës së Apelit, si dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës. Të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 26 nëntor 2018, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dokumentet e kërkuara.

9. Më 18 dhjetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 27 tetor 2016, Prokuroria Themelore, Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë ngriti aktakuzë (PP. nr. 438) kundër parashtruesit të kërkesës për arsye se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale “lëndim i lehtë trupor” nga neni 188, paragrafi 1 në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK). Me të njëjtën aktakuzë për bashkëkryerje të njëjtës veprë të lartcekur penale ishin akuzuar edhe dy persona të tjerë.
11. Më 23 gusht 2017, Gjykata Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) me Aktgjykimin P. nr. 649/2016 shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për arsye se në bashkëkryerje kishte kryer veprën penale “lëndim i lehtë trupor” dhe e dënnoi atë me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh.
12. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës dhe L. P. parashtruan “ankesë të përbashkët” për shkak të vendimit mbi lartësinë e dënimit në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tyre, parashtruesi i kërkesës dhe L. P. pohuan se Gjykata si rrethanë shtesë lehtësuese duhet të marrë për bazë edhe faktin se me të dëmtuarin “*nuk kanë raporte të acaruar*”, dhe si rrjedhojë propozuan që dënimi më i butë, respektivisht dënimi me gjobë, do të arrinte qëllimin e dënimit.
13. Më 9 tetor 2017, Prokuroria e Apelit [Shkresa PPA/II. nr. 1126/17] i propozoi Gjykatës së Apelit refuzimin e ankesës, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe L. P.
14. Më 21 nëntor 2017, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1. nr. 1110/2017 refuzoi ankesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe L. P. si të pabazuar.
15. Gjykata e Apelit vlerësoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me dënimin nuk janë të bazuara. Gjykata e Apelit më tej vërtetoi se Gjykata e shkallës së parë, respektivisht Gjykata Themelore në lidhje me “*çështjen e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit*” drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenet 73 dhe 74 të KPK-së, të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit, përfshirë edhe rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, që ndikojnë edhe në arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 34 të KPK-së.
16. Ndërsa në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe L. P.-së për shndërrimin e dënimit me burg në dënim me gjobë, Gjykata konstatoi se një kërkesë e tillë është dashur të parashtrohet në gjykatën e shkallës së parë, respektivisht në Gjykatën Themelore pas shqiptimit të dënimit.
17. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit PA1. nr. 1110/2017 të Gjykatës së Apelit, të 21 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit P. nr. 649/2016 të Gjykatës Themelore, të 23 gushtit 2018, parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

18. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje esenciale të ligjit penal dhe të dispozitave të procedurës penale. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, në mënyrë specifike pretendoi si në vijim:
- (i) Sipas tij, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK) nuk parasheh mundësinë e paraqitjes së ankesës së përbashkët. Sipas parashtruesit të kërkesës, kjo parregullsi është dashur të eliminohet nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht Gjykata Themelore, dhe në rast se kjo nuk është bërë nga gjykata e shkallës së parë, atëherë këtë parregullsi është dashur ta eliminojë Gjykata e Apelit;
 - (ii) Në kundërshtim me nenin 55, paragrafin 1 të KPPK-së, i cili përcakton që *“Në një procedurë penale, mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje.[...]”*, në seancën e Kolegjit të Gjykatës së Apelit kishte marrë pjesë mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës i cili kishte mbetur pranë ankesës së përbashkët të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe L.P.
 - (iii) Në lidhje me konstatimin e Gjykatës së Apelit se kërkesa për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë pas shqiptimit të dënimit është dashur të parashtrohet në gjykatën e shkallës së parë, respektivisht në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës pretendon se dispozitat e KPPK-së nuk e kufizojnë mundësinë e parashtrimit të një kërkeje të tillë edhe në fazat e mëvonshme; dhe
 - (iv) Parashtruesit të kërkesës i *“është shkelur e drejta në mbrojtje”*, respektivisht atij i është shkelur e drejta në mbrojtës në kuptim të nenit 384, paragrafit 2, pika 1 të KPPK-së. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon po ashtu shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenit 53 të Kushtetutës.
19. Më 30 prill 2018, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Pml. nr. 36/2018 kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës e refuzoi si të pabazuar.
20. Së pari, Gjykata Supreme, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me *“të drejtën për të pasur mbrojtës”* konstatoi se në procedurën pranë Gjykatës Themelore *“të dënuarit”* nuk kanë pasur mbrojtës dhe se për të drejtën e tyre për të pasur mbrojtës janë njoftuar nga kjo gjykatë. Gjykata Supreme duke iu referuar procesverbalit të shqyrtimit fillestar nga Gjykata Themelore [P. nr. 649/2016, të 27 tetorit 2016] rikujtoi se parashtruesi i kërkesës ka deklaruar se do të mbrohet pa mbrojtës. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme duke u referuar edhe dispozitave të KPPK-së, respektivisht nenit 57, paragrafit 1 arsyeton se nuk ishin plotësuar kriteret e përcaktuara për të pasur mbrojtje të detyruar. Në anën tjetër, Gjykata Supreme po ashtu konstatoi se nuk janë plotësuar edhe kriteret e përcaktuara në nenin 58, paragrafin 1 të KPPK-së për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike.
21. Së dyti, Gjykata Supreme konstatoi se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se një mbrojtës ka përfaqësuar dy të dënuar është i pabazuar. Në lidhje me këtë,

Gjykata Supreme duke u referuar shkresave të lëndës arsyetoi se parashtruesi i kërkesës dhe L. P. nuk kanë angazhuar mbrojtës në procedurën penale pranë Gjykatës Themelore. Gjykata Supreme rikujtoi se pas përfundimit të procedurës penale në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës dhe L. P. kishin paraqitur një ankesë të përbashkët kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe se në procedurë pranë Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës ka angazhuar si mbrojtës avokatin [A. R.], cili në seancën e Kolegjit të Gjykatës së Apelit *“ka deklaruar se ngelë pranë ankesës dhe pretendimeve të ankesës së parashtruar”*. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerësoi se: *“nuk ka ekzistuar mundësia që ankesa e përbashkët e të dy të dënuarve të konsiderohet si e palejuar sepse ata me vullnetin e tyre e kanë përpiluar një ankesë të këtillë. Në anën tjetër, avokati i cili është angazhuar më vonë, në fazën e seancës së shkallës së dytë vetëm nga njëri prej të dënuarve, konkretisht nga [parashtruesi i kërkesës], nuk i ka ngelur mundësia tjetër por që të përkrah ankesën e parashtruar. Ai nuk ka qenë në situatë që “ankesën ta ndajë” dhe nuk mund të konsiderohet se ai, në kundërshtim me dispozitën e nenit 55 të KPPK-së ka mbrojtur dy të dënuar”*.

22. Së treti, Gjykata Supreme në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë konstatoi se ky pretendim po ashtu është i pabazuar. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerësoi se *“mundësia e zëvendësimit të dënimit me burgim deri në 6 muaj me dënim me gjobë, është mundësi e cila i jepet gjykatës e cila ka shqiptuar dënimin, pra gjykatës së shkallës së parë.”* Gjykata Supreme, në këtë rast ju referua nenit 47 të KPK-së që përcakton se: *“Kur gjykata shqipton dënim burgim me deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar”*. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, *“[...] kjo mundësi e zëvendësimit të dënimit është në diskrecionin e gjykatës sepse nuk është imperativ ligjor dhe, së dyti, i jepet vetëm gjykatës së shkallës së parë dhe jo edhe gjykatës së instancës më të lartë”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, nenin 11 të DUDNJ-së dhe nenin 14 të PNDKP-së, si dhe me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
24. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, në mënyrë specifike pretendon si në vijim:
25. Së pari, sipas parashtruesit të kërkesës mundësia e parashtrimi të ankesës së përbashkët nuk ekziston, përkatësisht sipas tij një mjet i tillë ligjor nuk është i paraparë me dispozitat e KPPK-së.

26. Së dyti, sipas parashtruesit të kërkesës, në seancën shqyrtuese të Kolegjit të Gjykatës së Apelit, kishte marrë pjesë përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës *“i cili kishte mbetur në tërësi pranë ankesës së përbashkët”*. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pohon se kjo është në kundërshtim me nenin 55, paragrafin 1 të KPPK-së, i cili parasheh që: *“Në një procedurë penale, mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje [...]”*.
27. Së treti, në lidhje me konstatimin e Gjykatës së Apelit se kërkesa për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë ishte e paafatshme, parashtruesi i kërkesës pretendon se ky konstatim është i paqëndrueshëm, dhe në lidhje me këtë specifikon se sipas dispozitave të KPPK-së *“nuk është e përcaktuar se kur duhet të paraqitet kërkesa”*. Në lidhje me këtë, parashtruesi pohon se interpretimi restriktiv i dispozitave të KPPK-së paraqet shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
28. Së katërti, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur *“e drejta në mbrojtje”*, përkatësisht parashtruesi i kërkesës specifikon se *“mbrojtja efektive në çështje penale, duke pasur parasysh në veçanti garantimi i të drejtës në mbrojtje si mënyrë e ruajtjes së interesit të drejtësisë dhe garantimit të barazisë së palëve si parim themelor në procedurë penale”*. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se *“ka rëndësi të posaçme që i pandehuri të jetë i barabartë me prokurorin e shtetit i cili përfaqëson organin e akuzës, që shprehet me parimin e barazisë së palëve në procedurë penale”*. Parashtruesi i kërkesës, më tej thekson: *“e drejta e të pandehurit që të ketë mbrojtës në procedurë penale është e karakterit absolut, dhe si e tillë paraqet obligim për shtetin që të sigurojë avokatin mbrojtës në të gjitha rastet kur i pandehur”*.
29. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës i referohet parimit të *“barazisë së palëve”* në procedurë penale, duke nënvizuar se ky parim garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 11 të DUDNJ-së, dhe nenin 14 të PNDKP-së. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se e *“drejta në mbrojtje”*, respektivisht e drejta për caktimin e avokatit pa pagesë është zhvilluar si standard edhe në kuadër të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës vazhdon duke nënvizuar se *“[...] ky standard i shprehet nga GJEDNJ, është obligator edhe për gjykatat në Kosovë, ashtu që i pandehuri jo vetëm që duhet të ketë të caktuar një avokat mbrojtës, por edhe që detyrimet e avokatit që mbrojtjen ta ushtroj në mënyrë efektive”*. Sipas parashtruesit të kërkesës gjykata duhet të ketë një rol aktiv, duke u kujdesuar që të pandehurit të kenë një *“përfaqësim adekuat në procedurë penale”*.
30. Në lidhje me pretendimin e lartcekur për shkeljen e të drejtës në mbrojtje, parashtruesi i kërkesës thekson se e drejta e angazhimit të mbrojtësit me shpenzime publike në procedurë penale është e paraparë edhe me dispozitat e KPPK-së. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe nenit 9 të KPPK-së, i cili përcakton që: *“Nëse me këtë Kod, nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë”*. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është cenuar e drejta në mbrojtje, siç garantohet edhe me nenin 384, paragrafit 2, pika 1 të KPPK-së. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës përfundon që në procedurën penale të zhvilluar në Gjykatën Themelore është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me

nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, parashtruesi në kërkesën e tij i përmend parimet e vendosura në kuadër të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, pa specifikuar apo përmendur ndonjë rast konkret në kuadër të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që do të ishte i aplikueshëm në rastin e tij.

31. Dhe në fund, përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon që Gjykata Supreme vetëm sipërfaqësisht i ka shqyrtuar “shkeljet procedurale”, ndërsa fare nuk i ka shqyrtuar dhe adresuar pretendimet e tij për shkelje, të paraqitura në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Parashtruesi i kërkesës në këtë kontekst pretendon se Gjykata Supreme gabimisht ka interpretuar faktet dhe ligjin, dhe si rrjedhojë i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
32. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, respektivisht rastit *Tatishvili kundër Rusisë*, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58, dhe rastit *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33, specifikon se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar vendimin e saj.
33. Në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që ta aprovojë kërkesën e tij dhe të anulojë: Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, PKR. nr. 649/2016, të 23 gushtit 2017; Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1. nr. 1110/2017, të 21 nëntorit 2017, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 36/2018, të 30 prillit 2018.

Dispozitat relevante ligjore

Kodi Penal Nr. 04/L-082 i Republikës së Kosovës

Neni 47

Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar.

Kodi Nr. 04/l-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Neni 9

Barazia e palëve

1. *Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.*

2. I pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori i shtetit të thërret dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.

3. I dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëjë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij dhe ka të drejtë për të bërë deklaratë mbi të gjitha faktet dhe provat. Ai ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët, t'u parashtrojë pyetje të tërthorta dëshmitarëve të palës tjetër dhe të kërkojë nga prokurori i shtetit që të thirren dëshmitarët.

4. Nëse prokurori i shtetit vlerëson se gjatë hetuesisë janë mbledhur prova të mjaftueshme për të vazhduar në shqyrtim gjyqësor, prokurori i shtetit harton aktakuzën dhe paraqet faktet mbi të cilat ai e bazon aktakuzën dhe siguron provat për këto fakte.

Neni 55

Kufizimet në përfaqësim nga mbrojtësi

1. Në një procedurë penale, mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje. Një mbrojtës nuk mund të përfaqësojnë personin juridik dhe personin fizik në të njëjtin rast, përveç nëse personi fizik është i vetmi person që ka në pronësi, menaxhon dhe është i punësuar nga personi juridik.

2. I pandehuri mund të ketë deri në tre mbrojtës dhe e drejta për mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit.

3. Nëse i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, njëri nga ta caktohet si mbrojtës kryesor nga i pandehuri, e në rast se i pandehuri nuk bën një gjë të tillë, gjyqtari kompetent cakton mbrojtësin kryesor.

Neni 57

Mbrojtësi në rastet e mbrojtjes së detyruar

1. I pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar:

1.1. nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses;

1.2. gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim;

1.3. nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim;

1.4. në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm; dhe

1.5. në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënim me së paku një (1) vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi.

2. Në qoftë se i pandehuri në rastin e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush nga personat në nenin 53. paragrafi 8. i këtij Kodi, gjykata ose një organ tjetër kompetent i cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike. Kur mbrojtësi caktohet sipas detyrës zyrtare pasi të jetë ngritur aktakuza, i pandehuri njoftohet për këtë me rastin e dorëzimit të aktakuzës.

3. Në qoftë se i akuzuari në rastin e mbrojtjes së detyruar mbetet pa mbrojtës gjatë procedurës dhe nëse ai nuk angazhon mbrojtës tjetër, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues apo organi kompetent që e zbaton procedurën në fazën paraprake cakton një mbrojtës të ri sipas detyrës zyrtare në shpenzime publike.

4. Personi juridik nuk ka të drejtë në mbrojtës të caktuar me shpenzime publike.

Neni 58

Mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar

1. Kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse:

1.1. nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet, ose

1.2. këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.

2. I pandehuri njoftohet për të drejtën e tij në mbrojtës me shpenzime publike sipas paragrafit paraprak para se të merret në pyetje për herë të parë.

3. Kërkesa për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të bëhet gjatë gjithë procedurës penale. Kryetari i gjykatës ose organi kompetent i cili zbaton procedurën në fazën paraprake vendos për kërkesën dhe cakton mbrojtës. Nëse policia ose prokurori i shtetit refuzon kërkesën e të pandehurit për t'i caktuar mbrojtës me shpenzime publike, i pandehuri mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake.

4. Para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike sipas këtij neni, i pandehuri duhet të plotësojë një deklaratë duke cekur pasuritë e tij dhe të deklarohet se nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtësit ligjor.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjukata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjukata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afati]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

37. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 36/2018, të 30 prillit 2018, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i ka sqaruar pretendimet e tij për ato të drejta dhe liri që ai pretendon se i janë shkelur përmes vendimeve gjyqësore, në pajtim me kushtet që kërkohen nga neni 48 i Ligjit si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
38. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

39. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së si dhe me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi pothuajse në tërësinë e kërkesës së tij para Gjykatës përsërit të njëjtat pretendime, të cilat i kishte paraqitur edhe në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Në lidhje me pretendimet e sipër cekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar, në thelb pretendon se (i) parashtruesit të kërkesës gjatë zhvillimit të procedurës penale pranë Gjykatës Themelore i është shkelur e drejta në mbrojtës, të cilin pretendim e ndërlidhë me barazinë e armëve në procedurë penale dhe se (ii) Gjykata Supreme nuk i ka arsyetuar pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës përkitazi me procedurën penale të zhvilluar pranë Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, të specifikuara në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë.
41. Prandaj, Gjykata në vijim, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me të drejtën në mbrojtës dhe të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor do t'i elaborojë në dritën e garancive procedurale të garantuara me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

1. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e të drejtës në mbrojtës

42. Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], paragrafi 5 i Kushtetutës, përcakton:

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

[...]

(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;

[...]

43. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafi 6 i Kushtetutës, përcakton:

[...]

6. Ndhimja juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

[...]

44. Neni 6 paragrafi 3 c) i KEDNJ-së, parasheh që:

*“3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
(...)*

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”.

1.1. Parimet themelore mbi të drejtën në mbrojtës sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së

45. GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore ka ritheksuar “[...] edhe pse jo absolute, e drejta e secilit, i cili është akuzuar për një vepër penale që në mënyrë efektive të mbrohet nga një avokat është një nga veçoritë themelore të gjykimit të drejtë” (shih rastet e GJEDNJ-së, *Salduz kundër Turqisë* [DHM], kërkesa nr. 36391/02, Aktgjykim i 27 nëntorit 2008, paragrafi 51, *Demebukov kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 68020/01, Aktgjykim i 28 shkurtit 2008, paragrafi 50, *Ibrahim dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], kërkesat nr. 50541/08, 50571/08, 50573/08 dhe 40351/09, Aktgjykim i 13 shtatorit 2016, paragrafi 255).
46. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6, paragrafi 3, pika c, përmban tri të drejta të ndryshme: (i) atë për t'u mbrojtur vetë; (ii) atë për të pasur ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur vetë dhe (iii) të ndihmës juridike falas nga një avokat (shih rastin *Pakelli kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 8398/78, Aktgjykim i 25 prillit 1983, paragrafi 31).
47. Marrë për bazë kontekstin e rastit konkret, Gjykata në vijim do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkritazi me të drejtën për t'u mbrojtur vetë dhe të drejtës për ndihmë juridike falas.

Përkritazi me të drejtën për t'u mbrojtur vetë

48. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për t'u mbrojtur vetë nuk garantohet në mënyrë absolute. Çështja nëse të akuzuarit i lejohet për t'u mbrojtur vetë apo t'i caktohet një avokat është në varësi të legjislacionit vendor në fuqi apo rregullave të gjykatës përkatëse. Në këtë rast, shtetet anëtare gëzojnë hapësirë për vlerësim dhe janë në pozitë më të mirë për të zgjedhur mjetin që këshillohet në kuadër të sistemit të tyre gjyqësor për të garantuar të drejtat e mbrojtjes (shih rastin *Correia de Matos kundër Portugalisë* [DHM], kërkesa nr. 56402/12, Aktgjykim i 4 prillit 2018, paragrafi 122).
49. Në këtë aspekt, GJEDNJ po ashtu ka vlerësuar se, i akuzuari mund të heqë dorë nga e drejta e tij për ndihmën e një avokati. Megjithatë, përpara se për një të

akuzuar të mund të konstatohet se, me sjelljen e tij, ka hequr dorë në mënyrë të heshtur nga një e drejtë e rëndësishme që rrjedh prej nenit 6 të KEDNJ-së, duhet që të vërtetohet se ai kishte mundësi të arsyeshme për t'i parashikuar pasojat e veprimeve të tij (shih rastin *Pishchalnikov kundër Rusisë*, kërkesa nr. 7025/04, Aktgjykim i 24 shtatorit 2009, paragrafi 77).

Përkitazi me të drejtën për ndihmë juridike falas

50. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për ndihmë juridike falas u nënshtrohet dy kushteve (shih rastin *Quaranta kundër Zvicrës*, kërkesa nr. 12744/87, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 27, *Caresana kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 31541/96, Vendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2000). Së pari, i akuzuari duhet të provojë pamundësinë e tij financiare (shih rastin e sipërcituar *Caresana kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Së dyti, shtetet kontraktuese janë të detyruara të ofrojnë ndihmë juridike vetëm “kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”, të cilat duhet të vlerësohen duke marrë parasysh faktet e çështjes në tërësi (shih rastin e sipërcituar *Quaranta kundër Zvicrës*, kërkesa nr. 12744/87, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 27).
51. Në vijim, GJEDNJ, në rastet kur vendosë përkitazi me kriterin “kur interesat e drejtësisë e kërkojnë” që një të akuzuari t'i caktohet përfaqësim ligjor falas, ka përcaktuar edhe disa kriteret shtesë, të cilat, ndër të tjera përfshijnë seriozitetin e veprës penale dhe ashpërsinë e dënimit në fjalë. Në parim, GJEDNJ ka vlerësuar se kur privimi i lirisë është në rrezik, interesat e drejtësisë kërkojnë përfaqësim ligjor (shih rastin *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], kërkesa nr. 19380/92, Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 61; shih rastin e cituar më lart *Quaranta kundër Zvicrës*, paragrafi 33). Si kriter tjetër i vendosur nga GJEDNJ është edhe kompleksiteti i rastit (shih rastin e cituar më lart *Quaranta kundër Zvicrës*, paragrafi 34) si dhe situata personale e të akuzuarit (*Zdravko Stanev kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 32230/04, Aktgjykim i 6 nëntorit 2012, paragrafi 38).

1.2. Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rrethanat e rastit konkret

52. Gjykata rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës, i cili thekson se në procedurën penale pranë Gjykatës Themelore i është cenuar e drejta e tij në mbrojtës. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës përveç pretendimit të tij për shkelje të së drejtës në mbrojtës, në mënyrë specifike ngritë edhe çështjen e “caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike”.
53. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës përfundon që në procedurën penale të zhvilluar në Gjykatën Themelore është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtruesi në kërkesën e tij në vazhdimësi i referohet parimeve të vendosura në kuadër të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, pa specifikuar apo përmendur ndonjë rast konkret të GJEDNJ-së që do të ishte i aplikueshëm në rastin e tij.
54. Së pari, përkitazi me “të drejtën për të pasur mbrojtës”, këtë pretendim parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur për herë të parë në kërkesën e tij për

mbrojtje të ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar, duke iu referuar procesverbalit të shqyrtimit fillestar nga Gjykata Themelore [P. nr. 649/2016 të 27 tetorit 2016], kishte vërtetuar se në procedurën pranë Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës nuk kishte pasur mbrojtës dhe se për të drejtën e tij për të pasur mbrojtës ishte njoftuar paraprakisht nga Gjykata Themelore. Në vijim, Gjykata Supreme sërish duke iu referuar procesverbalit të sipërcekur të shqyrtimit fillestar kishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës kishte deklaruar se në procedurën penale të zhvilluar kundër tij do të mbrohet pa mbrojtës.

55. Në këtë kontekst, Gjykata po ashtu rikujton vlerësimin e Gjykatës Supreme, e cila kishte shqyrtuar edhe çështjen e mbrojtjes së detyruar. Gjatë vlerësimit të saj, gjykata, duke iu referuar kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 57 [Mbrojtësi në rastin e mbrojtjes së detyruar], paragrafin 1 të KPPK-së dhe rrethanave të parashtruesit të kërkesës, kishte konstatuar se nuk ishin plotësuar kriteret ligjore për të pasur mbrojtje të detyruar. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme kishte vërtetuar se Gjykata Themelore nuk kishte bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale, duke specifikuar se *“Konform nenit 57, par.1 të KPPK-së i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në raste të mbrojtjes së detyruar, nga marrja në pyetje për herë të parë, kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shprehë shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses; gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim; nga ngritja e aktakuzës kur aktakuza është ngritur për vepër penale të dënueshme me të paktën 10 vjet burgim dhe kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënimi me më së paku 1 vit burgim”*.
56. Prandaj, bazuar në parimet e përgjithshme të vendosura në praktikën e GJEDNJ-së përkitazi me të drejtën për t’u mbrojtur vetë dhe vlerësimin e Gjykatës Supreme, të cilin vlerësim e ka bazuar në rrethanat e rastit konkret dhe dispozitat përkatëse të procedurës penale, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij në mbrojtës, të garantuar me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë qartazi të pabazuara.

Përkitazi me pretendimin “të drejtën e angazhimit të mbrojtësit me shpenzime publike”

57. Në vijim, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për “të drejtën e angazhimit të mbrojtësit me shpenzime publike” Gjykata rikujton vlerësimin e Gjykatës Supreme e cila duke iu referuar nenit 58 [Mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar], paragrafi 1 të KPPK-së po ashtu kishte vërtetuar se nuk ishin plotësuar kriteret ligjore të përcaktuara me këtë dispozitë për angazhimin e mbrojtësit me shpenzime publike. Gjykata Supreme duke u bazuar në rrethanat e rastit kishte arsyetuar se: procedura penale e zhvilluar kundër parashtruesit të kërkesës nuk ka paraparë dënim me tetë vite burgim apo dënim më të rëndë; se në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk e kanë kërkuar interesat e drejtësisë që t’i caktohet mbrojtës me shpenzime publike, pavarësisht nga dënimi i parashikuar dhe se parashtruesi i kërkesës nuk

ka dëshmuar se nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për t'i përballuar shpenzimet e mbrojtjes së tij.

58. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se kriteret kryesore përkitazi me të drejtën në përfaqësim ligjor falas, të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të mishëruara edhe në dispozitat e KPPK, përkatësisht kriteri i pamundësisë financiare dhe “*kur interesat e drejtësisë e kërkojnë*” angazhimin e mbrojtësit me shpenzime publike janë shqyrtuar edhe vlerësuar edhe nga Gjykata Supreme. Përveç kësaj, Gjykata Supreme, gjithashtu e ka vlerësuar edhe kriterin shtesë përkitazi me lartësinë e dënimit të paraparë në procedurën penale, e që në rastin e parashtruesit të kërkesës dënimi i paraparë në procedurën penale të zhvilluar kundër tij është më pak se 8 (tetë) vjet.
59. Si rrjedhojë, Gjykata, duke marrë për bazë pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe bazuar në parimet e përgjithshme të vendosura në praktikën e GJEDNJ-së, e cila ka theksuar se e drejta për të pasur mbrojtës nuk është absolute dhe se kjo e drejtë duhet të interpretohet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe rrethanat konkrete të rastit, vlerëson se interpretimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme është i bazuar në ligj dhe i mbështetur në faktet e paraqitura para kësaj gjykate.
60. Prandaj, Gjykata gjen se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për cenimin e të drejtës së tij në mbrojtës, e cila është element përbërës i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë qartazi të pabazuara.

2. Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor

61. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme vetëm sipërfaqësisht i ka shqyrtuar “shkeljet procedurale”, ndërsa fare nuk i ka shqyrtuar dhe adresuar pretendimet e tij për shkelje, të paraqitura në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës nënvizon se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm përfshinë edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar.
62. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, e cila ka vlerësuar se, edhe pse autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6.1 të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*” (shih *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 45, shih rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 majit 2018, paragrafi 54).
63. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka theksuar se, megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit, ato, megjithatë, duhet të adresojnë pretendimet që janë qendrore për rastet e tyre (shih, *mutatis*

mutandis, rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53).

64. Rrjedhimisht, Gjykata përsërit se e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu edhe në atë material (shih *mutatis mutandis* rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).
65. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht vëren që Gjykata Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar. Si rrjedhojë e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme arsyetimin e saj, për t'i konstatuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës si të pabazuara, e kishte bazuar në dispozitat e procedurës penale dhe të Kodit Penal.
66. Së pari, përkitazi me pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës se dispozitat e KPPK-së nuk parashohin mundësinë e parashtrimit të “ankesës së përbashkët”, në seancën shqyrtuese të Kolegjit të Gjykatës së Apelit, kishte marrë pjesë avokati i parashtruesit të kërkesës, i cili kishte mbetur në tërësi pranë “ankesës së përbashkët”. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme, e cila thekson se “[...] nuk ka ekzistuar mundësia që ankesa e përbashkët e të dy të dënuarve të konsiderohet si e palejuar sepse ata me vullnetin e tyre e kanë përpiluar një ankesë të këtillë. Në anën tjetër, avokati i cili është angazhuar më vonë, në fazën e seancës së shkallës së dytë vetëm nga njëri prej të dënuarve, konkretisht nga i dënuari [parashtruesi i kërkesës], nuk i ka ngelur mundësia tjetër por që të përkrah ankesën e parashtruar. Ai nuk ka qenë në situatë që “ankesën ta ndajë” dhe nuk mund të konsiderohet se ai, në kundërshtim me dispozitën e nenit 55 të KPPK-së ka mbrojtur dy të dënuar”.
67. Së dyti, në lidhje me pretendimin se në dispozitat e KPPK-së nuk është e përcaktuar se kur duhet të paraqitet kërkesa për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë, Gjykata Supreme duke iu referuar nenit 47 të KPPK-së, kishte vërtetuar edhe konstatimin e Gjykatës së Apelit, duke arsyetuar se kjo mundësi e zëvendësimit të dënimit është në diskrecionin e gjykatës së shkallës së parë, e cila e ka shqiptuar dënimin.
68. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2018, i 30 prillit 2018 është i qartë dhe adreson pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë.
69. Prandaj, Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme plotëson standardet, për një vendim të arsyetuar, të elaboruara më lart.
70. Në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata vëren se në pretendimet e tij, të parashtruara në Gjykatë, kryesisht ngrit çështje të ligjshmërisë.

71. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rasti *García Ruiz* kundër *Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu, rastin KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
72. Për sa i përket pretendimeve të parashtuesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtuesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat* kundër *Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
73. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër, pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat pranë gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktgjykimit të kontestuar i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
74. Në fund, parashtuesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
75. Sa i përket pretendimit për shkelje të neneve 21, 22 dhe 54 të Kushtetutës Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës këto nene të Kushtetutës vetëm i ka përmendur pa dhënë shpjegime se si dhe në cilat rrethana të rastit këto dispozita kushtetuese janë cenuar. Ndërsa sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 53 të Kushtetutës, i cili shprehimisht përcakton se të drejtat dhe liritë themelore që garantohen me Kushtetutë duhet të interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata rikujton se rastet e GJEDNJ-së, të cilave parashtuesi i është referuar në kërkesën e tij, si raste të aplikueshme në pretendimin e tij për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, i ka trajtuar gjatë

shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimit të tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në tërësinë e këtij vendimi.

Përfundim

76. Si përfundim, dhe duke u bazuar në elaborimin e mësipërm, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse të ndjekura nga gjykatat e rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare, dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
77. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtuesit të kërkesës nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregulloren e punës, sepse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, duke marrë parasysh që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese dhe që parashtuesi i kërkesës nuk e dëshmon mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje kushtetuese.
78. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 18 dhjetor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

